
Funded by the European Union

OSCE Organization for Security and Co-operation in Europe

RAPORTI MBI MONITORIMIN E PROCESEVE GJYQËSORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Fakte për KOSOVËN



Nga Teoria në Praktikë 2.0

Vlerësim i Efektivitetit të Reagimit të Gjyqësorit ndaj Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
Periudha e shqyrtimit Qershor 2024 - Shtator 2026


SI E DIMË NËSE REFORMA PO GJEN ZBATIM NË PRAKTIKË?

Raporti ndërthur gjetjet nga praktika në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit me përcjelljen e reformave, për të vlerësuar nëse ndryshimet po reflektohen në praktikën e përditshme të drejtësisë.

VËZHGIM → GJETJE // SHPJEGIM → REKOMANDIM // ZBATIM → PRAKTIKË

Bazë e të dhënave:






Korniza analitike:

- drejtësia
- efikasiteti
- kapacitetet institucionale
- përdorimi strategjik i mjeteve juridike

REFORMA ËSHTË NJË PROCES
JO NJË ÇËSHTJE PO/JO

Institucionet e drejtësisë në Kosovë po kalojnë gjithnjë e më shumë nga miratimi i kornizave të reformave drejt zbatimit të tyre në praktikë. Rritja e përgjegjësisë institucionale është e dukshme në fushën e transparencës, planifikimit strategjik, digjitalizimit, koordinimit gjyqësor dhe angazhimit me gjetjet e monitorimit. Sfida e radhës është të vlerësohet nëse këto reforma po zbatohen në mënyrë të qëndrueshme për të përmirësuar cilësinë, kohëzgjatjen dhe parashikueshmërinë e trajtimit të rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Zbatimi i rekomandimeve të RTM-së për reforma



Kornizat e reformës po konsolidohen gjithnjë e më shumë. Sfida tani është që reformat të zbatohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të bëhen pjesë e praktikës së përditshme.

ÇFARË KA NDRYSHUAR QË NGA VITI 2024?

MENAXHIMI STRATEGJIK I RASTEVE

Një strategji e dedikuar për periudhën 2025–2027 tashmë i jep përparësi trajtimit efikas të rasteve të korrupsionit, keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe krimit të organizuar, e mbështetur nga mekanizma për raportim, planifikim dhe monitorim të rasteve.

KONSISTENCA GJYQËSORE

Gjykata Supreme ka zgjeruar opinionet juridike, përmbledhjet e praktikës gjyqësore dhe publikimin e vendimeve të përzgjedhura, si dhe ka forcuar bashkë-punimin me gjykatat e niveleve më të ulëta, me synim që praktika gjyqësore të jetë më e njëtrajtshme dhe më e parashikueshme.

DIGJITALIZIMI DHE TRANSPARENCA

Platformat për publikimin e informacionit, mjetet për menaxhimin e rasteve, regjistrimi audio dhe video, si dhe mekanizmat e komunikimit janë zgjeruar, megjithëse përdorimi i tyre mbetet i pabarabartë ndërmjet institucioneve dhe rasteve.

PËRGJEGJËSIA PËR REFORMAT

Institucionet e drejtësisë po angazhohen në mënyrë më sistematike me gjetjet e monitorimit dhe po i përfshijnë rekomandimet në strategji, trajnime dhe proceset e hartimit të politikave.

ÇFARË TREGOJNË PROVAT?

Pesë faktorë të përsëritur përcaktojnë nëse reformat në Kosovë sjellin përmisime në trajtimin e rasteve nga KOK. Gjetjet tregojnë për përgjegjësi institucionale më të fortë dhe një kornizë reformash në zgjerim, por edhe për boshllëqe të vazhdueshme midis masave formale dhe praktikës së qëndrueshme. Së bashku, këta faktorë tregojnë se në cilat fusha nevojitet zbatim më i thelluar, në mënyrë që reformat e fundit të sjellin rezultate të qëndrueshme.

01

Përgjegjësia dhe drejtimi i përbashkët i reformave

Përgjegjësia institucionale është forcuar. Institucionet e drejtësisë po angazhohen gjithnjë e më shumë lidhur me gjetjet e monitorimit dhe po i përfshijnë rekomandimet në strategji, trajnime dhe procese politikëbërëse. Hapi i rradhës është lidhja e kësaj përgjegjësie me zbatim më të qartë, përcjellje dhe rezultate të matshme.

02

Konsistenca, zbatimi i njëtrajtshëm i ligjit dhe parashikueshmëria

Më shumë vëmendje institucionale po i kushtohet harmonizimit të praktikës gjyqësore, por qasjet divergjente mbeten të dukshme në standardet e provave, shqyrtimin e aktakuzave, rigjykime, dënime, dënime plotësuese dhe interpretimin e rregullave procedurale. Sfida qëndron në shndërrimin e udhëzimeve dhe të koordinimit në një praktikë të qëndrueshme, që zbatohet njësoj në të gjitha çështjet dhe nivelet e gjykatave.

03

Kapaciteti, ekspertiza dhe cilësia e praktikës juridike

Mjetet e reformës po zgjerohen, por zbatimi i tyre ende ndikohet nga boshllëqet e kapaciteteve të specializuara, shërbimeve gjuhësore, ekspertizës financiare, personelit dhe përdorimit jo të njëtrajtshem të teknologjisë. Kapacitetet duhen kuptuar gjithnjë e më shumë jo vetëm nëpërmjet trajnimit, por edhe si mbështetje institucionale që mundëson përsëritjen e praktikave cilësore.

04

Të dhënat diagnostikuese dhe rezultatet domethënëse

Rezultatet e çështjeve duhet të lexohen përtej shkallës së dënimeve dhe lirimeve. Rastet e monitoruara të krimit të organizuar dhe korrupsionit vazhdojnë të tregojnë nivele të larta lirimi, procedura të gjata dhe rezultate të ndryshme në shqiptimin e dënimeve. Çështja kryesore në aspektin e politikave është se çfarë zbulojnë këto rezultate për provat, ndërtimin e çështjes, apelimet, sanksionet dhe qëndrueshmërinë e rezultateve gjyqësore.

05

Transparenca, besimi i publikut dhe kujtesa institucionale

Mekanizmat e transparencës janë zgjeruar, por qasja e parashikueshme në oraret e seancave dëgjimore, vendimet, aktakuzat dhe informacionin dygjuhësh mbeten të ndryshme. Bërja e publikimit rutinë dhe të përdorshëm do të forconte jo vetëm aksesin publik, por edhe qëndrueshmërinë ligjore, të mësuarit institucional dhe llogaridhënien.

HAPAT TUTJE

NGA REFORMA NË LETËR → TE ZBATIMI → TE KONSOLIDIMI

Jepni PËRPARËSI zbatimit

Përqendroni vëmendjen institucionale te reformat dhe rastet ku vonesat, mungesa e qëndrueshmërisë dhe pengesat operacionale ndikojnë më së shumti te rezultatet e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

STANDARDIZONI praktikën

Shndërrojini udhëzimet, strategjitë dhe praktikat e mira individuale në qasje të qëndrueshme për sa i përket menaxhimit të rasteve, arsyetimit ligjor, caktimit të dënimit, hetimeve financiare dhe shqyrtimit në apel.

KONSOLIDIMI i ndryshimit

Mbështetja e praktikave të përmirësuara përmes përcaktimit të qartë të përgjegjësive, sigurimit të burimeve, përdorimit të të dhënave, mbështetjes profesionale dhe mekanizmave të reagimit, në mënyrë që zbatimi të bëhet pjesë e praktikës së përditshme.

TË DHËNAT JANË FILLIMI I HISTORISË

Raporti fokusohet në katër çështje kryesore të politikave, të cilat së bashku tregojnë nëse reformat po ndikojnë në mënyrën se si, në praktikë, trajtohen rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

ÇFARË DUAM TË KUPTOJMË PËR KOSOVËN?

A ZBATOHEN NË PRAKTIKË GARANCITË PROCEDURALE?

Të shqyrtohet qasja në informacion, përfaqësimi efektiv ligjor, barazia e palëve, interpretimi dhe përkthimi, paanshmëria në sallën e gjyqit, si dhe nëse masat mbrojtëse procedurale mbeten efektive në procedurat komplekse dhe afatgjata.

A ZHVILLOHET TRAJTIMI I RASTEVE KOMPLEKSE NË MËNYRË TË PARASHIKUESHME?

Të shqyrtohet kohëzgjatja e procedurave, vazhdimësia e seancave, menaxhimi i gjykimit, rigjykimet dhe shqyrtimi në instancat e apelit, për të kuptuar se ku humbasin ritmin rastet komplekse dhe nëse masat e reja për menaxhimin e lëndëve po ndryshojnë këtë prirje.

A PO SJELLIN MJETET E DISPONUESHME LLOGARIDHËNIE TË EFEKTSHME?

Të shikohet përtej ekzistencës së mjeteve ligjore dhe të shqyrtohet mënyra se si ato përdoren, përfshirë hetimet financiare, konfiskimin, dënimet plotësuese, marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, si dhe nëse ato sjellin rezultate proporcionale dhe të qëndrueshme.

A MUND TË SIGUROJNË INSTITUCIONET CILËSI TË QËNDRUESHME DHE TË NJËTRAJTSHME?

Të shqyrtohen cilësia e aktakuzave, arsyetimi gjyqësor, shqiptimi i dënimeve, ekspertiza e specializuar, sistemet e vlerësimit të performancës dhe të nxënit institucional, për të parë nëse praktikat e mira po bëhen të qëndrueshme dhe të njëtrajtshme, në vend që të varen nga raste ose praktikues të veçantë.

NDIQNI MË TEJ TË DHËNAT.

Lexoni raportin e plotë.

Ky publikim është mbështettur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e OSBE-së dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e BE-së.

Për më shumë informata rreth Projektit Rajonal për Monitorimin e Proceseve Gjyqësore:

→ **osce.org/westernbalkanstrialmonitoring**

#RegTrialMonitoring